

V E N D I M
Nr.465, datë 3.7.2003

**PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
MODERNIZIMIT TË AGJENCISË NACIONALE TË TRAFIKUT AJROR, SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 58 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1995 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Punonjësit, që mbeten të papunë nga procesi i modernizimit të Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror, sh.a., të trajtohen financiarisht, për një periudhë 2-vjeçare, duke filluar nga çasti i shkëputjes së marrëdhënieve të punës, në masën 100 për qind të pagës bazë mujore, shtesës së vjetërsisë në punë dhe sigurimet e detyrueshme.

2. Për këta punonjës kjo periudhë pagese të njihet si vjetërsi në punë për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.

3. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi e kanë punonjësit, që kanë qenë të punësuar në këtë shoqëri për një periudhë kohe jo më pak se një vit, deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi dhe që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike, në formën e punësimit dhe të vetëpunësimit. Në rast të kundërt u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.

4. Fondet financiare, të nevojshme për kryerjen e pagesës dhe për sigurimet e detyrueshme, të përballohen nga Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror, sh.a. Pagesa të bëhet nga zyrat e punësimit në rrethet përkatëse, duke bërë kalimin e fondeve të mësipërme në Ministrinë e Punës dhe të Çështjeve Sociale.

5. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për nxjerrjen e udhëzimit përkatës dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano